



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 986/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevci kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga votuesi Pal Berisha, Syl Krasniqi, Ardian Berisha, Uka Atashi, Bekim Manaj, Qamil Lushi, Vezire Fetahaj, Drilon Berisha, Arber Krasniqi Artan Gjocaj, Sefedin Bezeraj, Genc Qerreti Votues nga Komuna e Pejës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar Apeli Anr.986/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga votuesit Pal Berisha, Syl Krasniqi, Ardian Berisha, Uka Atashi, Bekim Manaj, Qamil Lushi, Vezire Fetahaj, Drilon Berisha, Arber Krasniqi, Artan Gjocaj, Sefedin Bezeraj, Genc Qerreti Votues nga Komuna e Pejës, kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal në Pejë, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Pejë, në Vendvotimet 1723C/05R, 1724C/03R, 1724C/04R, 1714C/02R, 1726C/02R, 1704C/02R, 1723C/02R, 1713C/05R, 1713C/02R, 1716C/02R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimet të vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet i pabazuar, apeli në pjesën që ka të bëjë me kërkesën për rinumërimin e këtyre vendvotimeve: 1724C/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.986/2021, i ushtruar nga paraqitur nga votuesit Pal Berisha, Syl Krasniqi, Ardian Berisha, Uka Atashi, Bekim Manaj, Qamil Lushi,

Vezire Fetahaj, Drilon Berisha, Arber Krasniqi Artan Gjocaj, Sefedin Bezeraj, Genc Qerreti
Votues nga Komuna e Pejës, ne te cilën pretendojnë se kanë votuar për kandidatin Elton
Xhemajli dhe Fatime Shala kandidat te subjektit politik PDK. Te njëjtit theksojnë se
përkundër qe kanë votuar per kandidatet ne fjalë votat e tyre nuk i figurojnë ne Rezultatin
përfundimtar te KQZ-së. Si dëshmi kanë bashkangjitur deklaratat e tyre se kanë votuar për
kandidatet Elton Xhemajli dhe Fatime Shala.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit
105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit,
materialit zgjedhor dhe provave që gjenden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara në raport me kandidatin
Elton Xhemajli, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se
ka mospërputhje të votave të kandidateve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e
Pejës, nga subjekti politik PDK, dega Pejë, me provat e ofruara nga palët ankuese, votuesve
të potencuar si me lartë pasi qe nga rezultatet e publikuara të KQZ, ka mos përputhje të
numrit të votave, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i
urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga
subjekti politik PDK, dega Pejë për Vendvotimet si ne dispozitivin II dhe rezultati i dalë nga
ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen
e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se:
*“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia,
transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e
fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se
lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon
integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit,
ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave
Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës me te cilën refuzohet si në pikën IV, është i pa bazuar apeli në
raport me kandidaten Fatime Shala, për për vendvotimin 1724C/01R pasi që në këto
vendvotim ka me shumë vota se deklarata çka e pamundëson qe të dëshmohet se mund te
ketë pasur manipulim te votave në këto vendvotime dhe për më tepër në këtë Vendvotim
kandidatja Fatime Shala, nuk e ka përcaktuar se sa vota i ka pas dhe sa vota i mungojnë dhe

asnjë provë shkresore nuk gjendet në shkresat e lëndës që do të mund të vërtetohen pretendimet e ankuesve.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.986/21 më datë 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.